



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 3376 prot.

Gramsh, më 25 / 08 / 2026

RELACION

“Për miratimin e qëndrimit të Bashkisë Gramsh lidhur me Reformën Administrative-Territoriale.”

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shkresës Nr.3573 prot., dat 31.07.2026 me lëndë “Shkresë Përcjellëse e Projektligjit “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, protokolluar me tonën Nr.3186 prot., datë 03.08.2026 të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe kuadrit ligjor në fuqi për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore, paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Gramsh, qëndrimi i Bashkisë Gramsh lidhur me procesin e Reformës Administrative-Territoriale.

Reforma Administrative-Territoriale përbën një proces të rëndësishëm për organizimin territorial dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke synuar përmirësimin e qeverisjes vendore, rritjen e eficiencës administrative, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve.

Në kuadër të procesit të riorganizimit administrativo-territorial, **Bashkia Gramsh nuk preket drejtpërdrejt nga ndryshimet e propozuara**, pasi nuk parashikohet ndryshim i territorit, kufijve administrativë apo statusit të saj si njësi e vetëqeverisjes vendore.

Në këto kushte, Bashkia Gramsh vlerëson pozitivisht procesin e Reformës Administrative-Territoriale dhe shpreh mbështetjen e saj për një organizim territorial që synon forcimin e

funksionimit të pushtetit vendor, rritjen e eficiencës së administratës publike dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj komunitetit.

Ky qëndrim mbështetet edhe në faktin se Bashkia Gramsh, duke mos u prekur drejtpërdrejt nga riorganizimi territorial i propozuar, vijon të ruajë territorin, kufijtë administrativë dhe statusin e saj, duke garantuar vijimësinë e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Për sa më sipër, **proponohet që Këshilli Bashkiak Gramsh të miratojë qëndrimin pozitiv dhe mbështetës të Bashkisë Gramsh ndaj Reformës Administrative-Territoriale**, duke vlerësuar se ndryshimet e propozuara nuk prekin territorin, kufijtë administrativë dhe statusin e Bashkisë Gramsh dhe duke shprehur gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit institucional në kuadër të këtij procesi.

KRYETARI I BASHKISË
BESION AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3876 prot.



Gramsh, më 20 / 08 /2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ..2026

“Për miratimin e qëndrimit të Bashkisë Gramsh lidhur me Reformën Administrative-Territoriale.”

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjes e datës ____/09/2026;

VENDOSI:

1. Të miratojë qëndrimin pozitiv dhe mbështetës të Bashkisë Gramsh ndaj Reformës Administrative-Territoriale, sipas propozimit të paraqitur në kuadër të projektligjit “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
2. Të konstatojë se, sipas riorganizimit administrativo-territorial të propozuar, **Bashkia Gramsh nuk preket në territorin, kufijtë administrativë dhe statusin e saj si njësi e vetëqeverisjes vendore.**
3. Ky vendim t’u përcillet Kuvendit të Shqipërisë dhe institucioneve përgjegjëse, si qëndrim zyrtar i Bashkisë Gramsh në kuadër të procesit të Reformës Administrative-Territoriale.

Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit në fuqi.

SEKRETARI I KËSHILLIT

KRYETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI

ENIS ZANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, PYJEVE, BUJQËSISË DHE TURIZMIT

Nr. 3869 / prot.

Gramsh, më 23.09.2026

Lënda: **RELACION PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, KULLOTA DHE LIVADHE, FERMEREVE FIZIKE E JURIDIKE ME ANË TË KONTRATAVE QERAMARRËSE ME AFAT 10 VJET.**

Drejtuar: **KËSHILLIT BASHKIAK**
GRAMSH

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 3, gërma "ç", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, si dhe neni 54 gërma "k", të ligjit nr.111, datë 31.10.2024, Për disa ndryshime në ligjin 9693, datë 19.03.2007", "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, nenit 15 (përdorimi për kullotje), pikat 1,2,3,4,5 dhe 6, nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës), nenit 27, të VKM nr.467, datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", të VKM nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", kreu i II-të, "Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari, të Vendimit nr.11, datë 30.01.2026 të Këshillit Bashkiak për të miratuar listën e kullotave dhe livadheve të gatëshme për kullotje e kositje bari për sezonin përkatës si dhe miratimin e kontratës tip, të kërkesës NRREGJ.3869, datë 21.09.2026, nga fermeri Z.Englis Bollobani, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, (sektori i administrim të pyjeve dhe kullotave) si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh kërkon Këshillit Bashkiak miratimin e e dhënies në përdorim me

qira të kullotave për kullotje e kositje, për kontrat me afat 10 (dhjetë) vjeçare për kullotje, të kërkesës nga fermeri fizik/juridik.

I. Pyjet dhe kullotat publike të territorit të Bashkisë Gramsh bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive".

II. Për marrjen me qera të kullotave e livadheve publike për kullotje e kositje bari që janë shpallur në listën e kullotave të lira të miratuar nga Këshilli Bashkiak, në çdo rast kërkesit (personat fizik apo juridik), paraqesin kërkesën me shkrim në Bashkinë Gramsh pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, si më poshtë vijon:

a. Kërkesa do të përmbajë:

1. *Të dhënat e kërkesit, gjeneralitetet, vendbanimin, adresën e saktë, pikën e kontaktit.*
2. *Ekonominë kullosore që kërkohet, numrin e parcelës, sipërfaqen e saj.*
3. *Llojin e bagëtive dhe numrin e krerëve që do të kullosin.*
4. *Kohën e përdorimit të kullotës.*

b. Bashkëngjitur kërkesës së personave fizik ose juridik do të jenë dhe këto dokumenta si më poshtë:

1. *Certifikatën veterinare e cila lëshohet çdo vit nga shërbimi veterinar për gjëndjen epizootike të fermës së bagëtive.*
2. *Vërtetimin nga njësia administrative/bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkesi ka në pronësi.*
3. *Lista e objekteve që kërkohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes, si stane, përpunim bulmeti, ngrehinë ndihmëse për barinjtë, objekte ndihmëse për barinjtë, sipas rastit të kërkesit.*

c. Proçedurat e dhënies në përdorim të përkoshëm me kontratë qiraje referohen sipas afateve ligjore:

1. *Deri në 3 (tre) vjet, për kullotjen e bagëtive, zbatohet nga struktura përkatëse e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit në Bashki.*
2. *Deri në 10 (dhjetë) vjet, për kullotjen e bagëtive, kontrata e qirasë lidhet pasi të jetë marrë miratimi paraprak me vendim nga Këshilli Bashkiak dhe kontrata bëhet me akt noterial.*

III. Me anë të këtij relacioni i kërkojmë Këshillit Bashkiak të shpreh dakortësinë për vazhdimin e proçedurave të dhënies në përdorim me qira, fermerit z.Englis Bollobani, fondin pyjor/kullosor publik prej 98.8 ha, për kullotjen e 200 krerë dele, dhe për ndërtime provizore si qëndër stani e rrethuar 60 m², ngrehinë banimi për barinj 4 m², sipërfaqia e kërkuar për kullotë ndodhet në ngastrat nëngastrat nr.9, 10/a, 10/b, 11/a, 11/b dhe 46/b me sipërfaqe prej 98.8 ha, dhe, dhe objektet provizore ndihmëse në ngastrën nr.11/b në ekonominë pyjore "Dushku i Bulçarit", në pronësi të Bashkisë Gramsh.

Bashkëngjitur këtij relacioni, dokumentat e dorëzuar nga kërkuesi (fermeri), sipas Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".

Jemi në pritje të miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore.

KRYETARI

Besim AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3869/Prot.

3.

Gramsh, më 23. 08. 2026

P/V E N D I M

Nr. _____, datë ____/____/2026

P Ë R

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE DHËNIEN NË
PËRDORIM, KULLOTA DHE LIVADHE, ME KONTRATE QERAMARRËSE ME AFAT
10 VJET.

Këshilli i Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës _____.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 3, gërma "ç", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, si dhe neni 54 gërma "k", të ligjit nr.111, datë 31.10.2024, Për disa ndryshime në ligjin 9693, datë 19.03.2007", "Për Fondin Kullor" i ndryshuar, nenit 15 (përdorimi për kullotje), pikat 1,2,3,4,5 dhe 6, nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës), nenit 27, të VKM nr.467, datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", të VKM nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie të tyre për kullotje e kositje bari", kreu i II-të, "Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari, të Vendimit nr.11, datë 30.01.2026 të Këshillit Bashkiak për të miratuar listën e kullotave dhe livadheve të gatëshme për kullotje e kositje bari për sezonin përkatës si dhe miratimin e kontratës tip, Këshilli Bashkiak.

V E N D O S I:

1. Të shpreh dakortësinë për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim fond pyjor/kullor publik, fermerit z. Englis Bollobani, sipërfaqe prej 98.8 ha për kullotjen e 200 krerë dele, sipërfaqia e kërkuar për kullotë ndodhet në ngastrat nëngastrat nr.9, 10/a, 10/b,

11/a, 11/b dhe 46/b, dhe për ndërtime provizore si qëndër stani e rrethuar 60 m², ngrehinë banimi për barinj 4 m², sipërfaqia e kërkuar ndodhet në ngastrën nëngastrën nr.11/b, në ekonominë pyjore/kullosore "Dushku i Bulçarit", në territorin administrativ të Bashkisë Gramsh.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, Sektori i Administrimit të Pyjeve, si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, PYJEVE, BUJQËSISË DHE TURIZMIT

Nr. 3069/ Prot.

Gramsh, më 23.09.2026

MIRAZOL

KRYETARI DASHKISË

Besion LAJZ



Lënda:

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, KULLOTA DHE LIVADHE, FERMEREVE FIZIKE E JURIDIKE ME ANË TË KONTRATAVE QERAMARRËSE ME AFAT 10 VJET.

Drejtuar:

KRYETARIT TË BASHKISË

G R A M S H

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 3, gërma "ç", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, si dhe neni 54 gërma "k", të ligjit nr.111, datë 31.10.2024, Për disa ndryshime në ligjin 9693, datë 19.03.2007", "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, nenit 15 (përdorimi për kullotje), pikat 1,2,3,4,5 dhe 6, nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës), nenit 27, të VKM nr.467, datë 31.07.2025 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", të VKM nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", kreu i II-të, "Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari, të Vendimit nr.11, datë 30.01.2026 të Këshillit Bashkiak për të miratuar listën e kullotave dhe livadheve të gatshme për kullotje e kositje bari për sezonin përkatës si dhe miratimin e kontratës tip, të kërkesës NRREGJ.3869, datë 21.09.2026, nga fermeri Z.Englis Bollobani, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, (sektori i administrim të pyjeve dhe kullotave) si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh kërkon Këshillit Bashkiak miratimin e e dhënies në përdorim me

Bashkëngjitur këtij relacioni, dokumentat e dorëzuar nga kërkuesi (fermeri), sipas Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari".

Jemi në pritje të miratimit nga ana Juaj.

DREJTORI

Ardit JANÇA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GRAMSH
NJESIA ADMINISTRATIVE KUKUR

N^o 72 Prot

Kukur më: 18.09.2026

VËRTETIM

Vërtetojmë se z. Englis Bollolan është banor i fshatit Shocon i
Njesisë Administrative Kukur dhe kërkon të shtegëtojë (200) krerë
oleli për kullotë verore në Tegë të Olsarkut

Lëshojmë këtë vërtetim për efekt dokumenti sipas kërkesës të interesuarit.

ADMINISTRATOR I NJESISË
LUAN ZANI



Ferma me Kod : AL040934790075

Ferma me Kod : AL040934790075

Të Dhëna

Nr. Serial RF:

FR0000893

Personale të Pronarit

Emri ENGLIS
 Atësia OSMAN
 Mbiemri BOLLOBANI
 Nr. Personal (ID) J11220028M
 Vendlindja GRAMSH
 Datëlindja 1991-12-20
 Gjinia Mashkull
 Rrethi GRAMSH
 Bashki/Komunë KUKUR
 Fshati SNOSME
 Celular 684417963

Personale mbi Mbajtësin e Kafshës

Emri ENGLIS
 Atësia OSMAN
 Mbiemri BOLLOBANI
 Nr. Personal (ID) J11220028M
 Vendlindja GRAMSH
 Datëlindja 1991-12-20
 Gjinia Mashkull
 Rrethi GRAMSH
 Bashki/Komunë KUKUR
 Fshati SNOSME
 Celular 684417963

Inventari i Kafshëve që Gjenden në Fermë më datë 26/04/2014

Lloji i kafshëve	Të Leshta	Të Dhirta	Gjedhë	Derra	Njëthundrakë	Shpendë	Bletë	Qen	Mace	Të tjera
Nr.Total	240	65	16	0	4	50	54	0	0	0

Mbarshtimi (vetëm për të imtat):

OP/VA Ferma ka pjellë Sezonale
 ARDIAN HETEM HASA
 ZvRr KUJTIM FEJZO ÇEKREZI
 Tipi i Prodhimit PERZIER

Detaje mbi Datat e Nënshkrimit

Mbajtësi i Kafshës 2014-04-26
 OP/VA 2014-04-26
 ZVRr 2020-02-14

Mbi Fermën

Emri Subjektit:

Rrethi GRAMSH
 Bashki/Komunë KUKUR
 Fshati SNOSME
 Adresa
 Telefon Fiks
 Fax
 E-mail
 Gjatësi Gjeografike (X)
 Gjerësi Gjeografike (Y)

Mbi Njësi të tjera blegtorale

Ka Njësi të tjera blegtorale Jo

U krijua nga Leonard Bitri
 U krijua më 15/06/2014 08:58:53
 U ndryshua nga KUJTIM ÇEKREZI
 U ndryshua më 15/05/2026 03:59:32

AA. SIST. RUDA
 VETERINER ZYRTAR KONTROLL

Jayfom

